



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF
GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Komuna e Gjakovës

Në bazë të nenit 72.1 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, nenit 28, paragrafi 28.1 dhe nenit 29, paragrafi 29.1, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe kërkesës së menaxherit të kontratës me numër identifikues: 632-23-11829-1-1-1 dhe numër të brendshëm 632-23-172-111 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-24401, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore, më dt. 27.10.2025, Zyrtari përgjegjës i prokurimit, Ju njofton:

NJOFTIM

Për ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës

Neni 28, i KPK përcakton se “Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi”;

Neni 29 paragrafi 29.1 i KPK përcakton se “Palët duhet t’i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën”

Me dt.20.10.2025, Menaxheri i kontratës, përmes e-mailit i është drejtuar Zyrës së Prokurimit, me kërkesë për shkëputjen me marrëveshje të kontratës "Furnizim me material për laborator hematologjik-biokimik", e lidhur me dt.29.12.2023, me numër identifikues: 632-23-11829-1-1-1 dhe numër të brendshëm 632-23-172-111 dhe nr. te protokollit 01nr.410/04-24401;

Sipas Menaxherit të kontratës" Furnizim me material për laborator hematologjik-biokimik", pasi kjo kontratë është lidhur me sasi(kurse viteve tjera me njësi), sasia e parashikuar është hargjuar brenda një periudhe shumë më të shkurtër se sa është planifikuar .

Andaj, bazuar në nenin 28, paragrafi 28.1 dhe nenin 29, paragrafi 29.1 të KPK, si dhe kërkesën e menaxherit të kontratës, do të bëhet ndërprerja e kontratës me marrëveshje mes dy palëve kontraktuese.

Nga sa u tha më lartë, ju informojmë se kontrata e nënshkruar me datën 29.12.2023, me numër identifikues: 632-23-11829-1-1-1 dhe numër të brendshëm 632-23-172-111 dhe nr. te protokollit 01nr.410/04-24401, me titull " Furnizim me material për laborator hematologjik-biokimik", ne mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të furnizimeve MADEOKS sh.p.k,Vragoli (Magjistratja Prishtinë-Pejë), Fushë Kosovë, do te ndërpritet me marrëveshje mes dy palëve me date 28.10.2025.

Palët janë pajtuar që nuk do të ketë kërkesë për dëmshpërblim nga ana e Kontraktuesit e as penalizim nga ana e Autoritetit kontraktues.

Shkresës i bashkëngjiten kërkesa e Operatorit ekonomik dhe rekomandimi i Menaxherit të kontratës për shkëputje të kontratës.

Me respekt,

Udhëheqës i zyrës së Prokurimit





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATE:	24.10.25
NGA:	Kosovare Doli - Menaxhere e kontratës
PËR:	Faton Gutaj - Menaxher i Prokurimit
CC:	Adelina Shehu Kola -Drejtore në DSHMS
CC:	Ardian Gjini - Kryetar i Komunës së Gjakovës
TEMA:	Kërkesë për shkëputjen me marrëveshje të kontratës. "Furnizim me material për laborator hematologjik-biokimik"

Të nderuar,

Ju njoftoj se kontrata "Furnizim me material për laborator hematologjik-biokimik", e lidhur më datë 29.12.2023, me nr.identifikues: 632-23-11829-1-1-1 dhe nr.të brendshëm:632-23-172-111.kërkohet të ndërpritet me marrëveshje.

Arsyetimi:

Duke qenë se është harxhuar sasia e furnizimeve të produkteve pa të cilat nuk mund të funksionojnë shërbimet e laboratorit hematologjik-biokimik , kërkoj që të ndërmerren procedurat e nevojshme për shkëputjen e kontratës me marrëveshje.

Kjo kontratë është marrë në menaxhim nga **unë** gjatë fazës së zbatimit.

Me respekt,

Venera Shtaloja

From: Kosovare doliQMF <kosovaredoliqmf@gmail.com>
Sent: Wednesday, October 22, 2025 9:44 AM
To: Venera Shtaloja; Faton Gutaj; Adelina Shehu Kola; Arben Koshi
Subject: Kërkesë për shkëputjen e kontratës "Furnizim me material për laborator hematologjik-biokimik"

Caution! This message was sent from outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

Të nderuar,

Ju njoftoj se kontrata "Furnizim me material për laborator hematologjik-biokimik", e lidhur më datë 29.12.2023, është realizuar plotësisht dhe është harxhuar sasia e planifikuar me kontratë.

Kjo kontratë është marrë në menaxhim nga unë në gjatë fazës së zbatimit.

1

Duke qenë se është harxhuar sasia e furnizimeve, kërkoj që të ndërmerren procedurat e nevojshme për shkëputjen e kontratës me marrëveshje, për shkak të harxhimit të sasisë së furnizimeve.

Me respekt,

Kosovare Doli

Menaxhere e Furnizimit me material për laborator hematologjik-biokimik

Data: 22.10.2025

2